

UDHËZIM
Nr. 13, datë 25.7.2022

PËR MODELIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN LOKAL

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 36/2022, datë 14.4.2022, “Për organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”,

UDHËZOJ:

I. PJESA E PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e modelit të strategjisë për zhvillimin lokal për zonën “LEADER” që mbulon Grupi Vendor i Veprimit (GVV).

2. Strategjia e Zhvillimit Lokal hartohet e udhëhequr nga komuniteti, i nënshtrohet konsultimit publik dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e GVV-së.

II. INFORMACIONI QË DUHET TË PËRMBAJË MODELI I STRATEGJISË PËR ZHVILLIMIN LOKAL

1. Strategjia përmban të dhënat dhe shpjegimet që vlerësohen nga GVV-ja.

Strategjia duhet të ketë jo më pak se të dhënat si vijon:

HYRJE

Jepet një përshkrim i shkurtër i situatës të GVV-së, numri i banorëve dhe përkufizimi i zonës për të cilën ajo zbatohet. Analiza e nevojave të zhvillimit dhe potenciali konkurrues i zonës, përfshirë analizën e aspekteve të forta, dobësive, mundësive dhe risqeve në zhvillimin e zonës.

Përshkrimi i territorit.

Identifikimi i problemeve, shkaqeve, argumentimi i nevojës për ndërhyrje etj.

BAZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Informacion mbi regjistrimin në Gjykatë, Aktin e Themelimit dhe Statutin e përditësuar.

Detajohen organet vendimmarrëse dhe ekzekutive.

Pasqyrohet roli i autoriteteve publike.

VIZIONI I STRATEGJISË DHE MISIONI

Përshkrimi i strategjisë. Vizioni dhe misioni i qartë. Përshkrimi i procesit gjithëpërfshirës të komunitetit të zonës “LEADER” gjatë përgatitjes së saj.

IMPAKTI/INDIKATORËT

Cili do të jetë impakti i strategjisë, grupet që do të preken, si do të ndikohet në aspektin ekonomik, social, mjedisor.

Përcaktimi i indikatorëve SMART.

QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Cilat janë qëllimet e politikës dhe objektivave të saj, përshkrimi i karakteristikave inovative dhe të integruara të saj dhe një hierarki objektivash, duke përfshirë objektivat e matshme për rezultatet që do të arrihen. Në lidhje me rezultatet, objektivat mund të shprehen në terma sasiorë ose cilësorë.

MASAT PRIORITARE

Përcaktimi i masave konkrete që pritet të realizohen nga GVV-të, në territorin e caktuar, brenda një periudhe kohe të caktuar dhe me një buxhet të caktuar.

PLANI I VEPRIMIT, BUXHETI DHE KOORDINIMI

Hartimi i planit të veprimit, i cili përcakton veprimet konkrete që do të zbatohen për realizimin e objektivave të saj dhe arritjen e rezultateve.

PLANI I MONITORIMIT DHE MITIGIMI I RISQEVE

Përshkrimi i rregullave të menaxhimit dhe të monitorimit të strategjisë, aftësia e strukturës së GVV-së për të zbatuar strategjinë, si dhe përshkrimin e rregullave të detajuara për vlerësimin e zbatimit të saj.

PLANI FINANCIAR

Hartimi i planit financiar për zbatimin e strategjisë, si dhe burimet e financimit të tij.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet drejtoria përgjegjëse për politikën e zhvillimit rural dhe struktura përgjegjëse për grupet vendore të veprimit.
2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca